Vrasja e babë e bir në Shkodër/ Zbardhen detaje nga krimi i rëndë, autorët iu zunë pritë në rrugë, 57-vjeçari dyshohet se bashkëpunonte me policinë për...

30 Qershor, 2023 10:42

Madhësia e tekstit:

Detaje të reja janë zbuluar nga vrasja babë e bir e ndodhur ditën e djeshme në Shkodër, një krim i rëndë që tronditi jo vetëm qytetin veriperëndimor, por gjithë vendin. Gjokë Gurra, 57 vjeç dhe djali i tij Eduart Gurra, 31 vjeçjanë viktimat e kësaj ngjarje të rëndë në fshatin Bruçaj të njësisë Pult në Dukagjin.

Të dy po shkonin me fuoristradën e tyre drejt shtëpisë së djegur në Dukagjin dy ditë më parë. Ende pa mbërritur tek banesa e shkrumbuar disa persona i kanë zënë pritë dhe i kanë qëlluar me armë e zjarrit automatik kallashnikov duke i lënë të vdekur në vend brenda automjetit.

Ngjarja ka ndodhur tek një kthesë e padukshme në një zonë të pyllëzuar, afro 500 metër pa mbërritur tek banesa e djegur e Gjokë dhe Eduart Gurrës. Autorët i kanë zënë prit pasi kanë pasur informacionin e saktë se dy viktimat po shkonin drejt banesës së tyre të djegur dhe aty nga distanca i kanë qëlluar me breshëri plumbash automatiku duke bërë që të humbin jetën në mënyrë të menjëhershme.

Pasi janë siguruar se Gjokë Gurra dhe Eduart Gurra kanë ndërruar jetë, autorët janë larguar në drejtim të paditur. Një prej pistave kryesore të këtij hetimi lidhet me dhënien e informacionit të shtetasit Gjokë Gurra për policinë e shtetit në aksionet për asgjësimin e kanabisit në zonën e Dukagjinit. Gjokë Gurra para afro 20 vitesh ka qenë efektiv policie por ka ruajtur kontaktet dhe marrëdhëniet me ish-kolegët. Sipas burimeve, 57-vjeçari herë pas here ka informuar policinë e Shkodrës lidhur me parcelat e kultivuara me kanabis sativa në Dukagjin. Kjo mbetet ende një pistë hetimi e pakonfirmuar zyrtarisht.

Ndërkohë një tjetër pistë hetimi ku është përqendruar policia është edhe lëndët drusore ku babë e birë që mbetën të vrarë punonin prej vitesh duke i transportuar nga Dukagjini drejt Shkodrës, edhe pse kjo pistë është më pak e besueshme për grupin hetimor. Ndërkohë nuk përjashtohen edhe konflikte të tjera që Gjokë Gurra dhe djali i tij mund të kenë pasur me persona të ndryshëm. 57-vjeçari ishte edhe pronar i një lokali në afërsi të drejtorisë vendore të policisë Shkodër, ku edhe banonte prej vitesh.

Autorët e kësaj ngjarje ende nuk janë identifikuar dhe policia po punon për identifikimin dhe gjetjen e tyre. Zbardhja e ngjarjes mbetet e vështirë për shkak se forcat e policisë kanë mbërritur pas 2-3 orësh sepse rruga është e amortizuar në një terren të vështirë malor, çka i ka favorizuar autorët që të kryejnë vrasjen dhe të largohen në drejtim të paditur.

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: Eduart Gurra | Gjokë Gurra | Shkodër | vrasja

BW | Download on the App Store | GET IT ON Google Play

Kerko keto

LAJMET E FUNDIT

Ekzekutoi me armë zjarri 17-vjeçarin në Francë, efektivi i policisë i kërkon falje familjes së viktimës
30 Qershor, 2023

PSG rezervon Enrique, nga Hernandez tek Asensio, në Francë zbulojnë afrimet e para
30 Qershor, 2023

Iu premtua rritje page, punonjësit e Albpetrol në protestë, bëjnë denoncimin: Po na kërcënojnë të heqim dorë nga greva
30 Qershor, 2023

Tentativat për grushtin e shtetit, BBC: Wagner është ende duke rekrutuar ankitarë të rinj në Rusi
30 Qershor, 2023

"Rrugaç, hajdut!", plas sherri në Kolegjin Zgjedhor; Lefter Maliqi përplaset me përfaqësuesin e KGZ
30 Qershor, 2023

Tërmet me magnitudë 4.2 në Greqi, ja ku ishte epicentra
30 Qershor, 2023

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

TË NGJASHME

I vendosën tritol në garazhin e banesës biznesmenit, kush janë dy 27-vjeçarët ish-futbollistë të shpallur në kërkim (Foto)
30 Qershor, 2023

Tritoli në banesën e biznesmenit në Shkodër/ Zbardhet ngjarja, policia identifikon 2 autorët, rezultojnë në kërkim pic...(Emrat)
30 Qershor, 2023

Taboola Feed

Man Who Made $95 million in 2008 Reveals New Prediction
VisionaryProfit | Sponsored

If you own a mouse, you will never turn off your computer again.
PanzerRaab | Sponsored

Çfarë ka ndodhur me vajzat e skandaleve me ish-ministra e zyrtarë të lartë? Nga Shukri Xhelili te Prifti dhe Pango, cilët ishin politikanët që përdorën...
Çfarë ka ndodhur me vajzat e skandaleve me ish-ministra e zyrtarë të lartë? Nga Shukri Xhelili te Prifti dhe Pango, cilët ishin politikanët që përdorën postin për të përfituar favore seksuale
balkanweb.com

Step Out in Style
Milla Evening Dresses
Milla | Sponsored
Shop Now

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Korrupsioni me tenderat e MSH, lihet në burg inxhinieri Sihx i Shehu
30 Qershor, 2023

Emri/ Kapet me kokainë në makinë, arrestohet 30-vjeçari shqiptar në Britanë, ja çfarë deklaroi ai
30 Qershor, 2023

Mori flakë një apartament në katin e 4-të të një pallati në Shkodër, detajet e para
30 Qershor, 2023

Ndërroi pa leje një objekt për qëllime biznesi, arrestohet 39-vjeçari në Kukës
30 Qershor, 2023

Ndërron jetë i riu në spitalin e Korçës, dyshohet se...
30 Qershor, 2023

Aksident i trafishëm në aksin rrugor Lezhë-Laç, bllokohet trafiku
30 Qershor, 2023

KATEGORIA VIDEO

VIDEO/ Moment i frikshëm, shihni si ikë 6-vjeçari nga 13 metra lartësi në një park argëtimi
30 Qershor, 2023

Aksioni në Elbasan për drogë dhe për 'peshkimin' e personazheve të krimit, zbardhen emrat e personave të arrestuar, mes tyre 2 gra
30 Qershor, 2023

VIDEO/ Arrestimi i dy shqiptarëve me kokainë në Greqi, dalin pamjet, ja ku e kishin fshehur drogën
30 Qershor, 2023

VIDEO/ Nga bllokimi i drogës, te arsenali i armëve dhe asai paraish, dalin pamjet nga megaoperacioni i Policisë në Elbasan
30 Qershor, 2023

Tensionet Prishtinë-Beograd/ Lela vë në pikëpyetje qëllimet e Ramës: Po lufton për peshën e vet para ndërkombëtarëve apo të Kosovës?
29 Qershor, 2023

"Më morën fëmijën tim", nëna e 17-vjeçarit që u vra në Francë: Nuk fajësoj policinë, por oficerin që e qëllon. Ai po fytyrën e një arabi
29 Qershor, 2023

© 2023 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.